

GJYKATA KOMUNALE NË PEJË

KA.nr.28/12

Datë 04 Prill 2012

Gjyqtari i EULEX-it për konfirmim të aktakuzës, Malcolm Simmons, në rastin penal kundër

BURIM SADIKU, i biri i Sylejman Sadikut dhe nënës Meliha Vokshi, lindur më 20 shator 1980, në Pejë, shqiptar, shtetas e Republikës së Kosovës, dhe

BAJRAM SADIKU, i biri i Ymer Sadikut dhe nënës Ganimete Sedefi, lindur më 18.07.1981 në Pejë, shqiptar, shtetas e Republikës së Kosovës

Të akuzuar në bazë të aktakuzës PPS.nr.52/10 të datës 25 nëntor 2011, e parashtruar në gjykatë më 29 nëntor 2011, për veprën penale *Shmangie nga Tatimi*, në kundërshtim të nenit 249 par. 1 dhe 2 të KPK-së

Pas shqyrtimit të akt-dorëheqjeve prej të pandehurve nga seanca për konfirmim të aktakuzës, parashtruar përmes avokatëve mbrojtës Gezim Kollcaku dhe Xhelal Radoniqi gjegjësisht, më 04 prill 2012 dhe në pajtim me nenin 310 par. 2 dhe nenin 316 par. 4 të KPPK-së, në vijim lëshon

AKTVENDIM

PRANOHET heqja dorë nga shqyrtimi i aktakuzës dhe provave, parashtruar nga të pandehurit Burim Sadiku dhe Bajram Sadiku përmes avokatëve të tyre mbrojtës Gezim Kollcaku dhe Xhelal Radoniqi.

ANULOHET seanca për konfirmim të aktakuzës e caktuar për datën 05 prill 2012.

Në bazë të nenit 316 par. 4 dhe 312 par. 1 të KPPK-së, aktakuza e ngritur nga Zyra e Prokurorisë Speciale, PPS.nr.52/10 e datës 25 nëntor 2011, KONFIRMOHET.

Aktakuza, së bashku me të gjitha të dhënat e dosjes së lendes, do ti dërgohen Kryetarit të Trupit Gjykses për shqyrtimin kryesor, menjëherë pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë.

Arsyetimi

Më 29 nëntor 2011, Zyra e Prokurorisë Special ka ngritur aktakuzën PPS.no.52/10 të datës 25 nëntor 2011 kundër të pandehurve Burim Sadiku dhe Bajram Sadiku për veprën penale *Shmangie nga Tatimi*, në kundërshtim të nenit 249 par. 1 dhe 2 të KPK-së. Aktakuza është ngritur në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

Gjyqtari për konfirmim në Gjykatën e Qarkut në Pejë, më 16 shkurt 2012 ka lëshuar një aktvendim në bazë të nenit 316 par. 3 të KPPK-së, e ka shpallur Gjykatën e Qarkut në Pejë si jo kompetente në lidhje me kompetencën lëndore dhe çështjen ja ka referuar Gjykatës Komunale në Pejë, si gjykatë kompetente.

Pasi pranimit të aktakuzës, Gjyqtari për konfirmim në Gjykatën Komunale, pas vlerësimit në pajtim me nenin 306 par. 2 të KPPK-së, konstaton se aktakuza është përpiluar në përputhje me nenin 305 të KPPK-së.

Pas kësaj, Gjyqtari për konfirmim ka caktuar seancën për konfirmim të aktakuzës për datën 05 prill 2012, dhe në të cilën Prokurori Special, të pandehurit Burim dhe Bajram Sadiku, avokatët e tyre mbrojtës Gezim Kollcaku dhe Xhelal Radoniqi ishin thirrur në mënyrë të rregullt.

Më 04 prill 2012, në bazë të nenit 309 par. 3 nen-par. 1 të KPPK-së, avokatët mbrojtës të të pandehurve, Gezim Kollcaku dhe Xhelal Radoniqi, secili prej tyre ka parashtruar akt-dorëheqjen nga shqyrtimi i aktakuzës dhe provave mbi të cilat ishte mbështetur prokuroria.

Pas rishikimit të akt-dorëheqjeve dhe duke pasur parasysh se secili prej të pandehurve përfaqësohen nga avokat mbrojtës me përvojë, gjyqtari për konfirmim është i bindur se të pandehurit kuptojnë pasojat e akt-dorëheqjes.

Në këtë mënyrë, gjyqtari për konfirmim të aktakuzës në bazë të nenit 310 par. 2 të KPPK-së, pranon akt-dorëheqjen dhe anulon seancën për konfirmim. Gjyqtari për konfirmim gjen se asnjëra nga rrethanat nga neni 316 par. 1 2, dhe 3 të KPPK-së, nuk ekzistojnë, prandaj lëshon aktvendimin në fjale, në bazë të nenit 316 par. 4 të KPPK-së.

Në bazë të neneve 316 (4) dhe 312 (1) të KPPK-së, gjyqtari për konfirmim konfirmon aktakuzën e lartpërmendur.

GJYKATA KOMUNALE NË PEJË , KA.nr.28/12 datë 04 prill 2012.



Gjyqtari për konfirmim të aktakuzës

Malcolm Simmons
Gjyqtar i EULEX-it

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.